




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr. 487/4 Prot.

Shkodër, më 04.01.2024

### V E N D I M

Nr. 24 Datë 28.12.2023

#### **“Mbi miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor për Këshillin e Qarkut Shkodër”**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023 me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër, **“Mbi miratim e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i buxhetit vjetor për Këshillin e Qarkut Shkodër”**, bazuar në nenin 41,77 dhe 78 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, paragrafi VII, neni 33 i Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Bazuar edhe në Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **15 Vota Pro, 0 Vota Kunder** dhe **0 Vota Abstenim**.

### V E N D O S I :

1. Të miratoje Kalendarin e përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe të buxhetit vjetor 2025, për Këshillin e Qarkut Shkodër, sipas tabelës së bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARE

Marina DUHANI





## KESHILLI QARKUT SHKODER

## KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM DHE I BUXHETIT VJETOR 2025-2027

PERIUDDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGEJGJËS	VEPRIMI PËRKATËS
Dhjetor	Brenda muajit Dhjetor	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Përgatit dhe paraqet në Këshillin e Qarkut kalendarin e programit buxhetor afatmesëm.
Dhjetor	Deri - 31 Dhjetor	Këshilli i Qarkut	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Janar	31	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Kryetari i njësive paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlerësimit të të ardhurave për PBA 2025-2027
Mars	1	Këshilli i Qarkut Shkoder	Paraqet në keshill e Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave per PBA-në 2025-2027
Mars	Brenda datës 15	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA
Mars	15	Këshilli i Qarkut	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027
Mars - Prill	21 Mars-25 Prill	Njësiti shpenzuese (sektoret)	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
Mars - Prill	26 Prill -27 Prill	Njësiti shpenzuese (sektoret)	Zhvillojnë takime konsultative me shoqërinë civile dhe grupet e interesit per PBA 2025-2027
Mars - Prill	28 Prill -30 Prill	Njësiti shpenzuese (sektoret)	Njësiti shpenzuese, sektoret paraqesin kërkesat e përgatitura
Maj	1 Maj - 15 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në qark	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	16 Maj - 26 Maj	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Organizon seancat dëgjimore me banorët
Maj	27 Maj - 29 maj	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Prezanton dokumentacionin e PBA 2025-2027 me shoqërinë civile
Maj	30 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në qark	Përpilon draftin e fazës së parë të PBA -se 2025-2027
Qershor	1	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri -20	Ministria e Financave	Dërgon komente një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 25	Njësia përgjegjëse për buxhetin në qark	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave
Qershor	Deri - 30	Këshilli i Qarkut	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 5 Korrik	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 te miratuar.
Korrik	Deri - 20 Korrik	Këshilli i Qarkut	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
Korrik - Gusht	26 Korrik - 31 Gusht	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe e shpërmdan tek njësiti shpenzuese
Shtator	1	Njësiti shpenzuese (sektoret)	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare
Shtator	2 Shtator - 14 Shtator	Njësiti shpenzuese (sektoret)	Njësiti shpenzuese paraqesin në qark kërkesat buxhetore të rishikuara
Shtator	Deri - 15	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Kryejne analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore
Shtator- Tetor	Deri 5 Tetor	Ministria e Financave	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar & rekomandimet MFE
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave	Organizohen seanca konsultimi me njësiti e vetëqeverisjes vendore
Tetor - Nëntor	6 Tetor - 30 Nëntor	Njësia përgjegjëse për buxhetin në qark	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të PBA
Dhjetor	25	Këshilli i Qarkut	Përgatit projektbuxhetin e vitit 2025 si dhe dokumentin e rishikuar të PBA 2025-2027 dhe paraqet për shqyrtim
Dhjetor	31	Kryetari i Keshillit të Qarkut	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtare dhe buxhetin vjetor
			Merr masat për publikimin e dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm







REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

### RELACION

**DREJTUAR :** Këshillit të Qarkut Shkodër.

**OBJEKTI :** “Mbi miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe buxhetit vjetor për Këshillin e Qarkut Shkodër.

Në zbatim të nenit 33 të Ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Këshilli i Qarkut Shkodër ka përgatitur Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 si dhe për buxhetin vjetor për vitin 2025.

Në ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, janë miratuar afatet në zbatim të cilave do të ndiqen procedurat për miratimin e Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 si dhe hartimin e buxhetit dhe menaxhimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2025.

Sipas kalendarit të hartuar dhe që po e paraqesim për miratim, janë përcaktuar hapat që do të ndiqen për hartimin e buxhetit dhe menaxhimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2025 si dhe për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027

#### ***Kalendari i PBA-së& buxheti vjetor;***

- Përgatitet nga Kryetari i njësisë së Vetëqeverisjes Vendore dhe i propozohet më tej këshillit të njësisë.
- Miratohet nga këshillit i njësisë brënda datës 31.12.2023.
- Hyn në fuqi nga njësia shpenzuese me datën 01.01.2024.

#### ***Vlerësimet dhe parashikimet e të ardhurave dhe shpenzimeve;***

- Kryetari paraqet për shqyrtim dhe miratim në këshill brenda datës 31.01.2024.
- Këshilli miraton raportin e vlerësimeve brenda datës 01.03.2024.

#### ***Tavanet e shpenzimeve të PBA-së ne nivel programi;***

- Kryetari i njësisë propozon tavanet përgatitore për miratim në këshill brenda datës 01.03.2024.
- Këshilli miraton tavanët përgatitore brenda datës 15.03.2024.
- Tavanet përfundimtare paraqiten paraqiten nga kryetari i njësisë në këshill brenda muajit korrik 2024.
- Këshilli miraton tavanet përfundimtare deri me datën 20 korrik 2024.

***Kërkesat sipas tavanëve;***



- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brënda tavaneve përgatitore të Njësisë së Menaxhimit të Programeve(Prill 2024) dhe japin argumente per fonde apo tavane shtesë.
- Njësitë shpenzuese paraqesin kërkesat brënda tavaneve përfundimtare deri me 01.08.2024.



#### **PBA&Buxheti vjetor;**

- Kryetari i Njësisë përgatit dokumentin e parë të PBA-së deri me 30.05.2024.
- Kryetari i Njësisë dërgon në MFE, dokumentin e PBA-së, brënda datës 01.06.2024.
- MFE-ja dërgon opinionin e saj mbi PBA-në tek njësia vendore deri me datën 20.06.2024.
- Kryetari i njësisë, dërgon PBA-në së bashku me opinionin e MFE-së për miratim në keshill deri me 21.06.2024.
- Këshilli i njësisë , miraton dokumentin e parë të PBA-së, deri me 30.06.2024.
- Kryetari publikon PBA-në deri me 05.07.2024.
- MFE-ja nxjerr udhëzimin plotësues për rishikimin e PBA-së deri me 10 korrik 2024.
- Njësia e rishikon PBA-në në periudhën korrik-gusht 2024.
- Njësia organizon takime konsultuese në periudhën 01-15 shtator 2024.
- Njësia dërgon PBA-në e rishikuar pranë MFE-së, deri me 15 shtator 2024.
- MFE-ja organizon seanca konsultimi me njësitë e qeverisjes vendore 01 deri me date 05.10.2024.
- MFE-ja dërgon opinionin përfundimtar sipas rastit të njësisë vendore deri me datën 20.10.2024.
- Kryetari i njësisë paraqet për miratim në keshill PBA-në dhe buxhetin përfundimtar vjetor datë 30.11.2024.
- Këshilli miraton PBA-në dhe buxhetin vjetor datë 25.12.2024.
- Kryetari i njësisë publikon PBA-në dhe buxhetin vjetor dhe materialet shoqëruese deri me 31.12.2024.

Keshilli i Qarkut Shkodër, në zbatim të kalendarit të vitit të kaluar, ka paraqitur për miratim buxhetin e vitit 2024, sipas afatit ligjor dhe kalendarit te miratuar për këtë qëllim.

Ketë Projekt –P/Vendim ju a paraqesim për MIRATIM.



Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU